



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë – E premte, 3 qershor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 382, datë 25.5.2016	Për disa shtesa në vendimin nr. 102, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”..... 5411
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 383, datë 25.5.2016	Për disa shtesa në vendimin nr. 103, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”..... 5411
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 25.5.2016	Për miratimin e dokumentit të politikave afatgjata për ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin nga administrata shtetërore në Shqipëri..... 5412
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 385, datë 25.5.2016	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) të mjediseve të pronës “ndërtesë - truall”, me nr. Pasurie 3/703, lagja nr. 1, Krujë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 818, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”..... 5426
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 386, datë 25.5.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës), shtesa”..... 5427
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 387, datë 25.5.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “përmirësimi i shtresave rrugore Fushë-Krujë - Thumanë”..... 5432
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 388, datë 25.5.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Librazhd – Qafa e Studnës (shtesa)”..... 5434

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 25.5.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 301, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 400 kv Vau i Dejës-Morinë”, të ndryshuar.....	5436
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 4129, datë 2.6.2016	Për delegim kompetence.....	5439

**VENDIM****Nr. 382, datë 25.5.2016**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN
NR. 102, DATË 4.2.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE
MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË
FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË
KOMBËTARE TË ZONAVE TË
MBROJTURA DHE TË
ADMINISTRATAVE RAJONALE TË
ZONAVE TË MBROJTURA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të nenit 23, të ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 102, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun I “Dispozita të përgjithshme”, shtohen pikat 5 e 6 me këtë përmbajtje:

“5. Punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale e Zonave të Mbrojtura pajisen me uniformë me shenja dalluese, me dokument identifikimi dhe me mjete të tjera teknike, të domosdoshme e të nevojshme për kryerjen e detyrës, për administrimin, mbrojtjen, parandalimin e dëmtimeve, zbulimin e veprimtarive kriminale dhe mbikëqyrjen në zonat e mbrojtura. Llojet e uniformave, shenjat dalluese, specifikimet teknike dhe çdo element tjetër për prodhimin dhe mbajtjen e uniformave e të pajisjeve teknike miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura.

6. Punonjësit e administratave rajonale e zonave të mbrojtura, që veprojnë në terren (rojet mjedisore), pajisen me armë, sipas ligjit nr. 74/2014, “Për armët”.”.

2. Në shkronjën “c”, të pikës 2, të kreut IV, “Përgjegjësitë dhe detyrat e AKZM-së dhe ADZM-ve”, shtohen dy nënpika, me këtë përmbajtje:

“- dhënie në përdorim të pjesëve të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura, pronë publike, referuar veprimtarive të lejuara për t’u

zhvilluar në zonat e mbrojtura, sipas përcaktimit të nenit 25, të ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, kundrejt tarifave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, nëpërmjet kontratave të nënshkruara nga drejtori i Administratës të Zonës së Mbrojtur, me miratim të drejtorit të Përgjithshëm;

- Rishikon, harton ose ndryshon kontratat ekzistuese të lidhura për sipërfaqet e zonave të mbrojtura nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor në rrethe përpara krijimit të AKZM-së.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi**VENDIM****Nr. 383, datë 25.5.2016**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN
NR. 103, DATË 4.2.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE
MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË
FUNKSIONIMIT TË INSPEKTORATIT
SHTETËROR TË MJEDISIT DHE
PYJEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11 e 51, pika 3, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kreun IV, të vendimit nr. 103, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Pas fjalës “Stema” shtohet fjala “...identifikimi...”;

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Punonjësit e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve dhe të degëve rajonale pajisen me uniforma me shenja dalluese, me dokumente identifikimi dhe me mjete të tjera teknike të domosdoshme e të nevojshme për kryerjen e detyrës, për mbrojtjen, parandalimin e dëmtimeve, zbulimin e veprimtarive kriminale dhe mbikëqyrjen në mjedis dhe në pyje. Llojet e uniformave, shenat dalluese, specifikimet teknike



dhe çdo element tjetër për prodhimin dhe mbajtjen e uniformave e pajisjeve teknike miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 384, datë 25.5.2016

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT
TË POLITIKAVE AFATGJATA PËR
OFRIMIN E SHËRBIMEVE ME NË
QENDËR QYTETARIN NGA
ADMINISTRATA SHTETËRORE
NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, shkronja “a”, e 56, paragrafi i dytë, të ligjit nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit

të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit të politikave afatgjata për ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin nga administrata shtetërore në Shqipëri, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, ministritë e linjës dhe institucionet e tjera të përmendura në këtë dokument për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

**DOKUMENTI I POLITIKAVE AFATGJATA
PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE ME NË QENDËR QYTETARIN NGA ADMINISTRATA
SHTETËRORE NË SHQIPËRI**
prill 2016

Lista e shkurtimeve të përdorura

ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ASP	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
DPA	Dokumenti i politikave afatgjata
GMIP	Grupi për Menaxhimin e Integruar të Politikave
IKQ	Indeksi i kënaqësisë së qytetarëve
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
M&V	Monitorimi dhe vlerësimi
MIAP	Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike
OSI	Indeksi i shërbimeve <i>on-line</i>
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SMP	Sistemi i Monitorimit të Performancës
SNASHD	Strategjia Ndërsektoriale “Afhenda për Shqipërinë Dixhitale”
SNRAP	Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike
TIK	Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit
TKP	Treguesit kyç të performancës



I. HYRJE

Marrja e statusit të vendit kandidat për në Bashkimin Evropian, në qershor 2014, i ka dhënë një impuls të shtuar reformave në Shqipëri.

Në drejtim të mirëqeverisjes inovative, një ndër gjashtë prioritetet¹ e qeverisë shqiptare për arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik dhe social, siç cilësohet dhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015–2020, në fokus është transformimi i mënyrës së ofrimit të shërbimeve në Shqipëri përmes qasjes me në qendër qytetarin. Kjo mishërohet në Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike (SNRAP) 2015–2020, e cila përbën kuadrin e përgjithshëm për modernizimin dhe transformimin e institucioneve dhe praktikave të administratës publike në vend, me vizionin e “sigurimit të shërbimeve me cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset në mënyrë transparente, efektive dhe efikase, nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve inovative, në përputhje me kërkesat e integritimit evropian, nëpërmjet nëpunësve civilë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm, pjesë e strukturave eficiente”. Strategjia Ndërsektoriale “Akhenda për Shqipërinë Dixhitale” (SNASHD) 2015–2020 e mbështet këtë vizion.

Në planin ndërkombëtar, vizioni i qeverisë shqiptare për shërbime me në qendër qytetarin mbështetet edhe në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm që u miratuan më 25 shtator 2015 nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe drejtpërdrejt në objektivin 16 për “Nxitjen e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimin e mundësisë për drejtësi për të gjithë dhe ngritjen e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse në të gjitha nivelet”.

Miratimi në Komitetin e Planifikimit Strategjik (KPS) në prill 2014, shënon fillimin e nismave nga qeveria shqiptare në kuadër të programit “Inovacioni kundër korrupsionit: Ngritja e një modeli shërbimesh me në qendër qytetarin” (ISDA), i cili ka marrë që në hapat e parë mbështetje nga partnerët ndërkombëtarë për zhvillim, si: PNUD-i, BE-ja, BB-ja, qeveria italiane dhe donatorë të tjerë.

Nën drejtimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP), programi ISDA ka në fokus reformën në shërbimet me natyrë administrative për qytetarin dhe biznesin, si në fushën e pronave, transportit, sigurimit shoqëror dhe atij shëndetësor, gjendjes civile, arsimit, lejeve të ndërtimit, regjistrimit dhe licencimit të biznesit. Ai përbëhet nga katër shtylla kryesore, që kanë të bëjnë me:

- i) rindëzimin e proceseve të dhënies së shërbimeve për qytetarët dhe bizneset duke përfshirë dhe reformën në fushën ligjore, TIK dhe atë institucionale;
- ii) ndarjen funksionale dhe integrimin e shërbimeve publike² në sportel dhe zhvillimin e kanaleve të ofrimit të tyre;
- iii) dixhitalizimin e arkivave e të regjistrave, ndërveprimin mes sistemeve TIK dhe shërbimet *on-line*;
- iv) marrjen e opinionit të qytetarëve dhe monitorimin e performancës së administratës shtetërore në dhënien e shërbimeve.

Në rrafshin institucional, aktorë kryesorë, të përfshirë në zbatimin e programit të reformës për shërbime me në qendër qytetarin, janë: Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), si dhe institucionet e administratës shtetërore shërbimofruese në fokus. Në aspektin ligjor, kjo reformë shumëplanëshe gjen shprehje në ligjin nr. 13/2016, datë 18 shkurt 2016, “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në

¹ Prioritetet e qeverisë shqiptare përfshijnë: 1) reformën e tokës dhe atë territoriale; 2) përmirësimin e sektorit energjetik; 3) menaxhimin e burimeve ujore e të infrastrukturës; 4) investimet e huaja direkte; 5) reformat strukturore për modernizimin dhe konsolidimin e institucioneve publike; 6) qeverisjen inovative.

² Sipas ligjit nr. 13/2016, datë 18 shkurt 2016, “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, neni 4: “Shërbim publik” është produkti që u ofrohet nga institucionet e administratës shtetërore, të pavarura dhe të qeverisjes vendore, brenda juridiksionit të tyre, personave fizikë dhe juridikë, në bazë të kërkesës së tyre dhe që rezultojnë në një përgjigje të formave të ndryshme, si certifikatë, licencë, leje, vërtetim etj., nga institucioni përgjegjës, i parashikuar në ligj.



sportel në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në marrëveshjen e huas me Bankën Botërore për projektin “Ofrimi i shërbimeve me në qendër qytetarin”, e cila ka hyrë në fuqi në datën 22 mars 2016.

Për të detajuar objektivat, parimet dhe ndërhyrjet kryesore për realizimin e vizionit strategjik dhe harmonizimin e veprimtarive mes të gjithë aktorëve të përfshirë, me nismën e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP), qeveria shqiptare ka hartuar këtë dokument politikash afatgjata për ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin nga administrata shtetërore në Shqipëri.

II. OBJEKTIVAT E POLITIKAVE

2.1 Fusha dhe koha e veprimit

Institucionet e administratës shtetërore, sipas ligjit, kanë si pjesë të përgjegjësive të tyre, dhënien e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset. Përkundër pritshmërive që përfituesit kanë, nisur dhe nga përvoja me standardet e shërbimit ndaj klientit në sektorin privat, si bankat, telekomunikacioni etj., problematikat me të cilat ata ndeshen rëndom në ndërveprimin me këto institucione kanë të bëjnë, në shkallë të ndryshme, me mungesë informacioni, transparence, përgjegjshmërie dhe eficiencë, si dhe raste korruptive.

Duke u fokusuar në shërbimet me natyrë administrative nga institucionet e administratës shtetërore, qeveria shqiptare synon realizimin e një ndryshimi transformues në marrëdhënien shtet-qytetar/biznes me impakt në fushën e shërbimeve publike në përgjithësi, duke përfshirë dhe ato të qeverisjes vendore dhe institucioneve të pavarura. Zgjidhjet inovative dhe të teknologjisë së informacionit konsiderohen si elemente me rol kritik në këtë proces.

Ndërhyrjet e parashikuara në kuadrin e DPA-së kanë në bazë kërkesat e përfituesve, të cilët përfshijnë të gjithë qytetarët shqiptarë dhe bizneset që operojnë në Shqipëri. Në vëmendje mbahen edhe qytetarët e huaj që jetojnë në vendin tonë. Qasja e bazuar në parimet e trajtimit të barabartë dhe të drejtë për të gjithë plotësohet dhe nga një vëmendje e posaçme ndaj shtresave në nevojë, të moshuarve, grave, personave me aftësi të kufizuar, minoriteteve dhe popullsisë rurale në përputhje me angazhimet përkatëse ligjore.

Nisur nga fusha e gjerë e veprimit, në fazën e parë (periudha deri në fund të vitit 2018) në fokus do të jenë shërbimet nga institucionet e administratës shtetërore që plotësojnë disa kriteret bazë, si numri i lartë i transaksioneve, prioritizimi nga qytetarët, nevoja e ndjeshme për ndërhyrje, si dhe përjasja me praktikën më të mirë ndërkombëtare në reformat e shërbimeve. Kjo fazë do të shënojë dhe fillimin e të gjitha ndërhyrjeve të parashikuara në DPA. Në fazën e dytë (2019–2025), konsolidimi i hapave të ndërmarrë do të shoqërohet me shtrirjen e veprimit në të gjitha shërbimet për qytetarët dhe bizneset nga institucionet e administratës shtetërore.

2.2 Rezultatet e pritshme

Objektivat e politikave për shërbime me në qendër qytetarin që rrjedhin nga dokumentet bazë: SKZHI, SNRAP-i dhe SNASHD-ja synojnë:

1. Reduktimin e kohës dhe barrës administrative për qytetarët dhe bizneset;
2. Përmirësimin e aksesit në shërbime dhe të cilësisë së ofrimit të tyre;
3. Shtimin e numrit të qytetarëve të kënaqur me shërbimet publike;
4. Uljen e korrupsionit, rritjen e eficiencës, transparencës dhe llogaridhënies në lëvrimin e shërbimeve.

Rezultatet e ndërhyrjeve të parashikuara në DPA, janë si vijon:

- Kalimi në shërbime 100% elektronike;
- Sigurimi i aksesit të shërbimeve për qytetarët kudo e në çdo kohë;
- Krijimi i një panorame 360 gradë të përfituesve;
- Arritja e një indeksi të lartë të kënaqësisë së qytetarëve;
- Klasifikimi i Shqipërisë ndër 20 vendet e para evropiane në indeksin e shërbimeve *on-line* (OSI)

sipas raportit të Kombeve të Bashkuara mbi qeverisjen elektronike.

2.2.1 Kalimi në shërbime 100% elektronike

- Kalimi në shërbime 100% elektronike i referohet një cikli të plotë shërbimi të lëvruar nga ofruesi te



përfituesi, i cili përfshin:

- marrjen e informacionit *on-line*;
- dorëzimin e aplikimit *on-line*;
- përpunimin e aplikimit në mënyrë të automatizuar, *on-line* (me ndërhyrje manuale minimale);
- ndjekjen *on-line* të statusit të një aplikimi;
- ofrimin e shërbimeve *on-line* për qytetarët dhe bizneset.

Shërbimet elektronike (*on-line*) u mundësojnë institucioneve të administratës shtetërore që të përfitojnë nga efikasiteti i përmirësuar i punës për t'iu përgjigjur dhe nevojave në rritje të qytetarëve dhe bizneseve për shërbime, duke shfrytëzuar plotësisht dhe hapësirat për riuinxhinierimin e proceseve të tyre dhe ndërveprimin me institucionet e tjera qeveritare.

Metoda “*on-line*” i referohet kanaleve të shumëfishta, si faqe në internet, platformë celulare apo qendër telefonike.

2.2.2 Sigurimi i aksesit të shërbimeve për qytetarët kudo e në çdo kohë

Aksesi në çdo kohë dhe në çdo vend nënkupton disponueshmërinë e shërbimeve në 7 ditët e javës, gjatë 24 orëve. Me zhvillimin e mëtejshëm të konceptit “Kudo e kurdo” nga institucionet e administratës shtetërore në Shqipëri, qytetarëve dhe bizneseve do t'u vihen në dispozicion një shumëllojshmëri kanalesh që do të mundësojnë aksesin në shërbime dhe do të lehtësojnë transaksionet, duke ofruar në çdo rast procedura të thjeshta që u kursejnë kohën.

2.2.3 Krijimi i një panorame 360 gradë për përfituesit

Krijimi i panoramës 360 gradë për përfituesit, pra një informacion i plotë dhe që merret në kohë në lidhje me shërbimet që i jepen qytetarit apo biznesit, është rezultat i një ndryshimi thelbësor nga qasja me bazë të ngushtë apo të izoluar institucionale te qasja që vë në qendër qytetarin. Kjo do të thotë që të realizohet një transparencë e plotë në lidhje me të gjitha përfitimet ose shërbimet që qytetari apo biznesi merr, duke iu referuar identifikimit të tij unik dhe sigurimit të domosdoshëm të ndërveprimit mes databazave të të gjitha institucioneve të administratës shtetërore. Avantazhet kryesore kanë të bëjnë me reduktimin e barrës burokratike për qytetarin dhe biznesin në marrjen e shërbimeve, shmangien e përfitimeve të pajustificuara, si dhe një ndikim të ndjeshëm pozitiv në politikëbërje.


2.2.4 Arritja e një indeksi të lartë të kënaqësisë së qytetarëve

Matja e indeksit të kënaqësisë së qytetarëve (IKQ) lidhur me shërbimet do të realizohet, e fokusuar në katër fusha: 1) Aksesi në informacion; 2) Lehtësia në marrjen e shërbimeve; 3) Cilësia e shërbimeve; 4) Afatet kohore për ofrimin e tyre. Kjo matje do të kryhet në mënyrë të rregullt përmes anketimeve, marrjes së opinionit apo konsultimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi për ofrimin e shërbimeve publike.

Kurdoherë që matja e kënaqësisë është nën 50 për qind, në nivel institucioneve do të kryhen analiza gjithëpërfshirëse të cilat do të shoqërohen me marrjen e masave për ndryshime dhe përmirësime, sipas detyrave funksionale që ka secili institucion i administratës shtetërore. Në rast se do të ketë më shumë se dy vlerësime të njëpasnjëshme më të ulëta se ky prag, çështja do të trajtohet në nivelin e zyrës së Kryeministrit apo atë të Komitetit Ndërmintoror përkatës, me synim rritjen e efektivitetit të llogaridhënies dhe të zbatimit të masave përkatëse.

2.2.5 Klasifikimi ndër 20 vendet e para evropiane në indeksin e shërbimeve *on-line* (OSI) sipas raportit të Kombeve të Bashkuara mbi qeverisjen elektronike

Renditja nga OKB-ja në lidhje me qeverisjen elektronike³ konsiderohet si një pasqyrë e progresit të bërë nga vende të ndryshme në drejtëm të përmirësimit të qeverisjes



³ Anketa nga UNPACS, në çdo 2 vjet, me fokus qeverisjen elektronike, në 193 shtete pjesëmarrëse, vlerëson ekosistemin e qeverisjes së çdo shteti të mundësuar nga teknologjia, përmes 3 treguesve, të cilët janë: OSI, indeksi i infrastrukturës së telekomunikacionit (TCI) dhe indeksi i kapitalit njerëzor (HCI). Mesatarja e secilit indeks përbën indeksin e përgjithshëm të zhvillimit të qeverisjes elektronike (EGDI).

duke përdorur TIK. OSI-së është një matricë vlerësimi e përbërë nga katër nivele, siç përshkruhet në diagramin përbri.

Në anketën e vitit 2014, Shqipëria renditet e 84-ta në klasifikimin botëror dhe e 33-ta në Evropë, për sa i përket klasifikimit sipas OSI-së.


Si pjesë e një angazhimi afatgjatë, synimi është që gjatë 10 viteve të ardhshme Shqipëria të klasifikohet ndër 20 vendet e para evropiane për sa u përket shërbimeve *on-line*.

III.PARIMET DHE NDËRHJRJET KRYESORE

3.1 Parimet bazë

3.1.1 Vendosja e qytetarit në plan të parë

Për të përmirësuar procesin e lëvrimin të shërbimeve nga institucionet e administratës shtetërore, si pjesë e qasjes që ka nevojat e qytetarëve në thelb të çdo vendimi, që nga formulimi dhe hartimi i strategjive deri te zbatimi i tyre, qeveria shqiptare do të fokusohet në disa drejtime kyçe, siç përmbledhet në skemën në vijim:



3.1.2 Qeveria si një e tërë

Angazhimi në kuadër të modelit të shërbimeve me në qendër qytetarin parashikon një qasje të integruar nën parimin “qeveria si një e tërë”. Ajo tejkalon këndvështrimin e fragmentuar institucional për të mundësuar një zhvillim, zbatim dhe ofrim më efikas të shërbimeve përmes përdorimit të unifikuar të të gjitha instrumenteve në dispozicion nga institucionet e administratës shtetërore.

“Qeveria si një e tërë” do të mundësojë një këndvështrim të plotë të qytetarit duke i bërë institucionet të jenë proaktive në ofrimin e shërbimeve gjatë të gjithë ciklit të jetës së tij. Ato do të kenë informacion më të plotë, të marrë në kohë dhe të gjithanshëm për përfituesit e shërbimeve.

Nga ana tjetër, përmes konceptit “Vetëm një herë” (*Once only*) që do të mundësohet nga e njëjta qasje e integruar, do të garantohet që qytetarët dhe bizneset t'i japin vetëm një herë të dhënat e tyre bazë,



duke i bërë institucionet përkatëse të administratës shtetërore që të kenë përgjegjësi që t'i regjistrojnë ato në mënyrën më optimale dhe t'i shpërndajnë ato në të gjithë rrejetin qeveritar. Kjo do të thotë që nuk do të jetë e nevojshme që qytetari apo biznesi t'i japë sërish këto të dhëna kur të marrë të njëjtin shërbim apo shërbime të tjera.

3.1.3 Reformat e proceseve

Reformat e proceseve i referohen transformimit të hapave të shërbimeve përmes kombinimit të veprimeve, ku përfshihen riinxhinierimi i proceseve të punës (BPR) dhe shfrytëzimi i zgjidhjeve që ofron teknologjia. Theksi do të vihet në transformimin e proceseve dhe jo thjesht në automatizimin e tyre apo ofrimin e shërbimit, siç është veçse *on-line*. Ky transformim përfshin dhe rishqyrtimin e arsyeve për të cilat është mandatuar shërbimi, kërkesat dhe mënyrat e ofrimit të tij, së bashku me parametra të tjerë, si afati kohor dhe ngarkesa për administratën.

Si pjesë e reformave të proceseve, qeveria shqiptare do të fokusohet edhe në konceptin “Dixhitalizimi në plan të parë” (*Digital first*) si nxitës për adaptimin e teknologjisë në mbështetje të mirëqeverisjes.

3.1.4 Standardizimi

Standardizimi në të gjitha shërbimet do të sigurojë për qytetarin dhe biznesin një përvojë të njëtrajtshme, të parashikueshme dhe me cilësi të lartë gjatë marrjes së tyre, pavarësisht se cili është institucioni përgjegjës apo kanali i përdorur. Kjo nënkupton, nga njëra anë, standarde të përbashkëta shërbimi bazuar në parimet e kujdesit për klientin dhe, nga ana tjetër, procedura të përcaktuara pune (*Standard Operating Procedures*) në të gjitha institucionet e administratës shtetërore.

3.1.5 Zhvillimi i kapaciteteve të qëndrueshme

PNUD-i e përkufizon zhvillimin e kapaciteteve si “procesi përmes të cilit individët, organizatat, institucionet dhe shoqëritë zhvillojnë aftësitë (individuale dhe kolektive) për të ushtruar funksionet, për të zgjidhur problemet dhe për të vendosur e arritur objektivat”⁴. Po ashtu, Banka Botërore e ka përkufizuar “kapacitetin” (përkundër veprimtarisë së ngritjes së kapaciteteve) si “kombinimi i burimeve njerëzore, institucioneve dhe praktikave që u mundëson vendeve të arrijnë objektivat e tyre të zhvillimit”⁵.

Burimet njerëzore mbeten element me rëndësi kritike për reformën. Zhvillimi i kapaciteteve të qëndrueshme është një qasje që do të fokusohet në mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore e të kompetencave të tyre në të gjitha institucionet që janë përgjegjëse për lëvrimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset.

3.1.6 Reformat ligjore

Duke synuar eliminimin e kufizimeve për zbatimin me efikasitet të reformës për shërbime me në qendër qytetarin, reformat ligjore do të përfshijnë kategoritë e mëposhtme të veprimtarive:

- Shqyrtimin e politikave bazë që lidhen me ofrimin e shërbimeve dhe identifikimin e nevojës për rishikimin e legjislacionit në fuqi;

- Hartimin e politikave të reja për zhvillimin e një sistemi modern shërbimesh, të transformuar dhe të personalizuar për të gjithë qytetarët dhe bizneset, si dhe vlerësimin paraprak për hartimin e instrumenteve të reja rregullatore;

- Përfshirjen e mjeteve e të teknologjive të reja për të mundësuar transformimin e lëvrimit të shërbimeve.

3.2 Ndërhyrjet kryesore

Si pjesë e politikave afatgjata për reformën e shërbimeve me në qendër qytetarin janë identifikuar disa kategori ndërhyrjesh kryesore, të renditura⁶ në tabelën e mëposhtme, të cilat vënë në praktikë parimet bazë të analizuara në seksionin pararendës.

⁴ Zhvillimi i kapaciteteve, PNUD, qershor 2009.

⁵ Raporti i vlerësimit të nevojës për mirëqeverisje, Banka Botërore, gusht 2008.

⁶ Renditja në tabelë nuk tregon radhë prioriteti apo zbatim. Ajo bazohet në një vlerësim mbi shkallën e kompleksitetit për realizimin e ndërhyrjeve, nga më e ulëta në më të lartën.



#	Parimet bazë Ndërhyrjet	Vendosja e qytetarit në plan të parë	Qeveria si një e tërë	Reformat e proceseve	Standar- dizimi	Reformat ligjore	Zhvillimi i kapaciteteve të qëndrueshme
1.	Përgatitja dhe publikimi i kartës së qytetarit	√			√		
2.	Zbatimi i një mekanizmi të qendëruar për ankesat	√	√	√	√		√
3.	Marrja e opinionit të qytetarit për çdo kërkesë për shërbim	√		√			√
4.	Trajnimi dhe shtimi i kapaciteteve		√		√		√
5.	Funksionimi i kanaleve të shumfishta të ofrimit të shërbimit	√	√			√	√
6.	Ndarja e funksionit të sportelit (<i>Front Office</i>) nga ajo e zyrës përgjegjëse të shërbimit (<i>Back Office</i>)		√	√	√	√	√
7.	Funksionimi i sistemit të menaxhimit të performancës				√		√
8.	Zbatimi i parimit FIFO (<i>First in, first out</i>)			√	√	√	
9.	Dhënia e arsyeve për rastet kur shërbimi nuk lëvrohet			√	√	√	
10.	Zbatimi i masave disiplinore për vonesat në lëvrimin e shërbimeve	√			√	√	
11.	Decentralizimi i kompetencës për ofrimin e shërbimeve	√	√	√		√	√
12.	Garantimi i së drejtës për shërbime	√			√	√	
13.	Kalimi në qeverisjen dixhitale	√	√	√	√	√	√
14.	Ofrimi i shërbimeve në mënyrë automatike	√	√	√		√	
15.	Zbatimi i miratimit në heshtje për shërbimet e përzgjedhura	√		√		√	

1. PËRGATITJA DHE PUBLIKIMI I KARTËS SË QYTETARIT

Përcaktimi i qëllimit, afateve kohore, roleve e përgjegjësive, si dhe matricës së përshkallëzimit për zgjidhjen e ankesave apo problemeve për të gjitha shërbimet nga institucionet e administratës shtetërore përmes hartimit dhe publikimit të kartës së qytetarit

Karta e qytetarit përfaqëson angazhimin e qeverisë në drejtim të standardeve, cilësisë, transparencës së shërbimeve, si dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve, duke përcaktuar qartë pritshmëritë. Ajo do të hartohet nga çdo institucion në bashkëpunim me ADISA-n, në zbatim të përgjegjësive të përcaktuara me ligj dhe të standardeve të unifikuara të miratuara për shërbimet ndaj qytetarit dhe biznesit. Në kartë do të përfshihen për çdo shërbim informacioni bazë për mënyrat/kanalet për marrjen e shërbimit, kërkesat dhe oraret, tiparet e matshme, si: kostoja, afatet, pika e kontaktit, si dhe procesi i trajtimit të ankesave.

Formulimi dhe publikimi gjerësisht i kartës në format të printuar apo elektronik do të realizohet duke pasur në vëmendje një qasje sa më të lehtë nga shtresat në nevojë dhe ato vulnerabël, duke përfshirë gratë, të moshuarit dhe minoritetet.

2. ZBATIMI I NJË MEKANIZMI TË QENDËRUAR PËR ANKESAT

Ndjekja e trajtimit të ankesave mbi çështjet që lidhen me marrjen e shërbimeve përmes zhvillimit dhe zbatimit të një mekanizmi të qendëruar.



Në mbështetje të një trajtimi të efektshëm dhe në kohë të ankesave nga qytetarët dhe bizneset në lidhje me procesin e lëvrimin të shërbimeve, ADISA do të zbatojë një mekanizëm të qendëruar që do t'i regjistrojë këto ankesa dhe do të ndjekë dhënien e përgjigjeve dhe adresimin e tyre në përputhje me afatet dhe përgjegjësitë e përcaktuara. Ky mekanizëm do të sigurojë dhe realizimin e përshkallëzimit në rritje të nivelit për trajtimin e ankesave sipas kuadrit të përcaktuar. Duke ofruar monitorim efikas të zbatimit të këtij kuadri, ai do të mundësojë dhe një element të rëndësishëm në vlerësimin e performancës së administratës shtetërore, si dhe do të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të lëvrimin të shërbimeve.

Për zbatimin e saj efikas, kjo nismë do të funksionojë duke u mbështetur nga zgjidhje TIK.

3. MARRJA E OPINIONIT TË QYTETARIT PËR ÇDO KËRKESË PËR SHËRBIM

Ndërveprimi me qytetarët në mënyrë më proaktive duke kërkuar opinionin e tyre për çdo kërkesë për shërbim.

Për rritjen e numrit të qytetarëve që japin opinion për marrjen e shërbimeve, qeveria shqiptare do të mundësojë akses në çdo kohë dhe çdo vend në mekanizmin e marrjes së mendimeve e sugjerimeve të tyre, duke vënë në dispozicion një sërë kanalesh:

- i) te sportelet/qendrat e shërbimeve publike, përmes formularëve të posaçëm të disponueshëm si në print dhe on-line në momentin e marrjes së shërbimit;*
- ii) nëpërmjet celularit, përmes SMS-ve dhe krijimit të një aplikacioni të posaçëm;*
- iii) nga qendra e kontaktit në numrin unik për shërbimet, përmes thirrjeve telefonike dalëse në drejtim të aplikantit dhe ato hyrëse nga ky i fundit.*

Sistemi për marrjen e opinionit të aplikantëve do të mundësojë këtë ndërveprim për çdo rast shërbimi, duke inkurajuar ato nga shtresat në nevojë dhe vulnerabël. Ai do t'i shërbejë matjes së nivelit të kënaqësisë së qytetarëve dhe bizneseve; identifikimit të problemeve në lëvrimin e shërbimeve, duke përfshirë dhe ato të karakterit gjinor dhe të rasteve të korrupsionit; monitorimit të performancës, si dhe zhvillimit të strategjive për përmirësimin e këtyre shërbimeve.

4. TRAJNIMI DHE SHITIMI I KAPACITETEVE

Realizimi i një kuadri gjithëpërfshirës për shtimin e kapaciteteve dhe trajnimin në institucionet e përfshira në lëvrimin e shërbimeve për qytetarët.

Angazhimi i qeverisë shqiptare në drejtim të zhvillimit të kapaciteteve të duhura të qëndrueshme në administratën shtetërore për realizimin e objektivave të reformës për shërbime me në qendër qytetarin do të jetë i vazhdueshëm. Fushat e veprimit, duke pasur në vëmendje zbatimin e politikave gjinore, do të përfshijnë:

i) Rritjen e kapaciteteve;

Zbatimi me sukses i reformës do të kërkojë individë me aftësi në një sërë drejtimesh si në periudhë afatshkurtër, ashtu dhe afatgjatë. Duke u mbështetur në kërkesat për llogaridhënie, fleksibilitet, nevojat e shtrira në kohë, natyrën e ekspertizës, disponibilitetin dhe konsiderata të raportit efikasitet-kosto, qeveria shqiptare do të shfrytëzojë punësimin e punonjësve brenda administratës apo të kontraktorëve të jashtëm në bazë individuale apo në nivel kompanie. Sipas rastit, do të ndërmerret një veprim i qendëruar për qasje të integruar apo në nivel institucioni.

ii) Trajnimin.

Realizimi i përputhjes së kompetencave të punonjësve të administratës shtetërore me kërkesat e punës sipas objektivave të reformës për shërbime me në qendër qytetarin do të realizohet në mënyrë të qendëruar dhe të vazhdueshme, përmes një kuadri trajnimi të strukturuar dhe gjithëpërfshirës, siç përshkruhet në skemën në vijim. Ai do të bazohet në bashkëpunimin e ngushtë mes ADISA-s, institucioneve shërbimofruese dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA).



5. FUNKSIONIMI I KANALEVE TË SHUMËFISHTA TË OFRIMIT TË SHËRBIMIT

Zhvillimi dhe funksionimi i kanaleve të shumëfishta të integruara të ofrimit të shërbimeve për të siguruar akses “Kurdo dhe kudo” për qytetarët.

Mundësimi i lëvrimet të shërbimeve përmes kanaleve të ndryshme është një komponent i rëndësishëm për zbatimin e parimit “Vendosja e qytetarit në plan të parë” pasi u lejon qytetarëve të marrin shërbimet që u nevojiten në mënyrën më të përshtatshme për ta. Kjo ndërhyrje ka një ndikim të drejtpërdrejtë në nivelin e aksesit për popullsinë rurale, shtresat në nevojë, gratë, të moshuarit, minoritetet dhe personat me aftësi të kufizuar dhe merr parasysh tiparet e përfituesve, tendencat e zhvillimit në vend dhe hapësirat e bashkëpunimit me qeverisjen lokale e sipërmarrjen.

Në këtë kuadër, qeveria shqiptare do të ndjekë një qasje të integruar bazuar në zgjidhjet TIK, duke siguruar, nga njëra anë, një përvojë pa ngërçe dhe të njëtrajtshme për qytetarët dhe, nga ana tjetër, një funksionim më të bashkërenduar ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore. Kjo qasje do të thotë që, për shembull, një qytetar mund të aplikojë për shërbimin përmes portalit *on-line* dhe do të mund të gjurmojë statusin e këtij shërbimi përmes një aplikacioni në celular apo duke telefonuar qendrën e kontaktit, pa llogaritur vizitën në sportelin fizik të shërbimit.

Në kanalet e shumëfishta të ofrimit të shërbimit do të përfshihen:

i) *Portali qeveritar e-Albania* www.e-albania.al, i cili do të shërbejë si dritarja e përgjithshme për qytetarët dhe bizneset për të aksesuar shërbimet *on-line*, si dhe informacionet për to;

ii) *celulari*, i cili, nisur dhe nga niveli i lartë i penetrimit në Shqipëri të telefonisë celulare, ka potencial të lartë përdorimi. Këtu përfshihen: a) SMS-të; b) aplikacionet në celular;

iii) *qendra e kontaktit për shërbimet*, e cila do të ofrojë një shumëllojshmëri opsionesh aksesit për qytetarët, duke filluar nga ai telefonik përmes një numri të vetëm unik dhe më pas *email-it* apo komunikimit *on-line*.

iv) *sportelet me një ndalesë*, ku përfshihen: a) sportelet e ndara pritëse për qytetarët dhe bizneset si dhe qendrat e shërbimeve të përqendruara në të njëjtën hapësirë; b) njësitë lëvizëse për ofrimin e shërbimeve, veçanërisht në zona të thella dhe ato me dendësi të ulët; c) kioskat kompjuterike me vetëshërbim.

6. NNDARJA E FUNKSIONIT TË SPORTELET (FRONT OFFICE) NGA AJO E ZYRËS PËRGJEGJËSE TË SHËRBIMIT (BACK OFFICE)

Ristrukturimi funksional duke përcaktuar ndarjen ndërmjet vendimmarrjes (BO) dhe ndërveprimit me qytetarin (FO).

Kjo ndërhyrje synon të përqendrojë rolin e BO-së në plotësimin e detyrave funksionale, ku përfshihet dhe marrja e vendimeve lidhur me kërkesën për shërbim nga qytetarët dhe bizneset, ndërkohë që FO-ja kujdeset për përvojën e qytetarit.

Qeveria shqiptare do të vijojë angazhimin në këtë drejtim për më shumë transparencë, llogaridhënie dhe fokus mbi qytetarin duke pasur parasysh që funksionet FO-BO plotësojnë njëra-tjetrën e janë të ndërvarura, si dhe duke ndjekur një reformë të dyanshme.

Realizimi i administrimit të FO-ve të ndara do të realizohet duke përdorur burime të brendshme ose duke angazhuar shërbim të jashtëm në bazë të kriterëve të mirëpërcaktuara teknike dhe standardeve të cilësisë.



7. FUNKSIONIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË PERFORMANCËS

Zhvillimi dhe zbatimi i një kuadri të menaxhimit të performancës në të gjitha institucionet e administratës shtetërore që kanë përgjegjësi në procesin e lëvrimin të shërbimeve për qytetarët dhe bizneset.

Për të garantuar që lëvrimi i shërbimeve të jetë sa më efikas dhe eficient, qeveria shqiptare do të miratojë dhe do të zbatojë një qasje shumëplanëshe ndaj menaxhimit të performancës, e cila përfshin elementet e mëposhtme:

i) *Zbatimin e një sistemi të monitorimit të performancës (SMP), i cili i referohet një platforme të centralizuar të mbështetur në zgjidhje TIK që do të ofrojë një panoramë të situatës së shërbimeve për qytetarët dhe bizneset pra: aplikimeve, shërbimeve të lëvruara, respektimit të afateve, ankesave, përfituesve, kanaleve të përdorura të ofrimit të shërbimit, si dhe do të mundësojë analiza krahasimore të performancës, në bazë kohore etj. Të dhënat do të bëhen publike on-line;*

ii) *Zhvillimin, përshatjen dhe zbatimin e një plani bazuar në rezultate për të ndjekur progresin e nismave specifike në nivel institucioni në drejtim të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët dhe bizneset. Kjo bazohet në përcaktimin çdo vit financiar të rezultateve të pritshme në kuadër të reformës për secilin institucion, dakordësimin me ta dhe ndjekjen e zbatimit të tyre;*

iii) *Konceptimin dhe zbatimin e programit të çmimeve dhe të vlerësimit, i cili do të vlerësojë, në ceremoni publike, çdo vit, individët dhe institucionet që kanë rezultatet më të mira në nivel kombëtar në arritjen e objektivave të treguesve kyç të performancës (TKP), në kuadër të reformës për shërbime me në qendër qytetarin. Qeveria shqiptare, gjithashtu, do të zbatojë një sistem renditjeje institucionesh në bazë të të dhënave të SMP-së, i cili do të bëhet publik.*

8. ZBATIMI I RREGULLIT “KUSH APLIKON I PARI, SHËRBEHET I PARI” (FIFO) PËR PËRPUNIMIN E SHËRBIMEVE

Ristrukturimi i lëvrimin të shërbimeve mbështetur në parimin “Kush aplikon i pari, shërbehet i pari” (FIFO).

Në frymën e rritjes së transparencës, trajtimit të barabartë dhe llogaridhënies, rregulli FIFO heq mundësinë për vendimmarrje arbitrare nga punonjësit e administratës shtetërore për radhën e shqyrtimit të aplikimeve për shërbimet nga qytetarët dhe bizneset. Ai e bën të detyrueshëm përpunimin brenda cילו institucion të të gjitha kërkesave sipas radhës së aplikimit, duke mos lënë hapësira për kapërcime për aplikime të veçanta. Nëse kërkohet përpunim prioritar, atëherë kjo do të realizohet përkundërt një kostoje shtesë të deklaruar. Për zbatimin efikas të rregullit FIFO vjen në ndihmë dhe përdorimi i zgjidhjeve TIK, i cili bën të mundur dhe monitorimin e proceseve në kohë reale.

9. DHËNIA E ARSYEVE PËR RASTET KUR SHËRBIMI NUK LËVROHET

Zbatimi i arsytimit të refuzimit për të gjitha shërbimet nga çdo institucion.

Zbatimi i detyrimit për arsytimin e detyrueshëm të refuzimit të kërkesës për shërbim dhe vënien e tij në dispozicion të aplikantit do të thotë që institucionet të kenë të identifikuar të gjitha arsyet e mundshme për refuzim të çdo shërbimi, të trajtojnë personelin lidhur me to dhe t’ia komunikojnë publikut në mënyrë të efektshme. Megjithëse nuk është rasti i një ndërhyrjeje të pastër teknologjike, mbështetja e kësaj nisme nga zgjidhje TIK kontribuon për zbatimin efikas të detyrimit për administratën shtetërore dhe përmirësimin e përvojës së qytetarëve.

10. ZBATIMI I MASAVE DISIPLINORE PËR VONESAT NË LËVRIMIN E SHËRBIMEVE

Zbatimi i masave disiplinore për punonjësit e administratës shtetërore për t’i bërë të papranueshme dhe të ndësbkueshme vonesat në lëvrimin e shërbimeve.

Institucionet e administratës shtetërore mbajnë përgjegjësi për ofrimin brenda afatit të shërbimeve dhe për trajtimin e ankesave në kohën e përcaktuar. Në këtë kuadër, çdo vonesë dhe çdo devijim në ofrimin e shërbimit apo trajtimin e ankesave përtej afateve të deklaruar në kartën e qytetarit do të trajtohet si e papranueshme dhe në këtë rast do të kërkohet zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi që rregullojnë procedimin disiplinor për punonjësit e administratës shtetërore.

Përcaktimi i roleve të qarta në lëvrimin e shërbimit, si dhe mbështetja në zgjidhje TIK për aktivizimin e njoftimeve apo kujtesave automatike gjatë procesit, ashtu si dhe i raporteve mbi afatet kontribuojnë drejtpërdrejt në zbatimin efektiv të masave disiplinore për vonesat.



11. DECENTRALIZIMI I KOMPETENCËS PËR LËVRIMIN E SHËRBIMEVE

Decentralizimi i autoritetit për të dhënë shërbime në nivelet bazë të administratës.

Si pjesë e programit të reformave të shërbimeve me në qendër qytetarin, qeveria shqiptare do të zbatojë konceptin e decentralizimit në *procedurat për dhënien e shërbimit*, duke synuar përmes riinxhinierimit të proceseve mundësimin e delegimit të kompetencave miratuese nga nivelet më të larta në ato më të ulëta, për më pak burokraci dhe shërbim të shpejtë dhe efikas.

Nga ana tjetër, në kuadrin e kësaj ndërhyrjeje parashikohet dhe decentralizimi i shërbimeve duke transferuar, rast pas rasti, dhënien apo delegimin e ofrimit të tyre te *qeverisja vendore*, duke pasur parasysh ndërveprimin e madh dhe pikat e kontaktit që ajo ka me popullsinë.

12. GARANTIMI I SË DREJTËS PËR SHËRBIME

Marrja e shërbimeve si një e drejtë themelore e qytetarëve.

Qeveria shqiptare është e angazhuar të garantojë standardet bazë për shërbimet për qytetarët dhe bizneset në kuadrin e së drejtës për shërbime. Si pjesë e këtij instrumenti ligjor do të përfshihen:

- detyrimi për të gjitha institucionet e administratës shtetërore për të formuluar dhe publikuar kartën e qytetarit;

- e drejta e qytetarëve për të marrë informacion për shërbimet dhe ecurinë e procesit të aplikimit, duke përfshirë arsyet e refuzimit, kur ka;

- një mekanizëm i plotë dhe funksional për shqyrtimin e ankesave;

- masat disiplinore në rast kapërcimi afatesh;

- e drejta për kompensim për qytetarin, nëse shërbimi nuk ofrohet sipas kartës së qytetarit;

- angazhimi për përmirësime të vazhdueshme në përgjigje të opinionëve të marra nga qytetarët.

13. KALIMI NË QEVERISJEN DIXHITALE

Kalimi brenda afateve të përcaktuara te sistemet TIK dhe shkëputja nga sistemet me bazë shkresash duke bërë të detyrueshëm zbatimin e parimit “Dixhitalizimi në plan të parë” për të gjitha institucionet e administratës shtetërore.

Kalimi në qeverisjen dixhitale i referohet politikës së kalimit të të gjitha proceseve dhe transaksioneve të shërbimeve nga të gjitha institucionet e administratës shtetërore në sisteme TIK brenda afatit kohor të përcaktuar. Këtu përfshihet edhe shkëputja nga kryerja e shërbimeve në mënyrë manuale me bazë shkresash.

Qeveria shqiptare është përqendruar dhe po investon në një program për dixhitalizimin e të dhënave, i cili përfshin procesin e kalimit në të dhëna dixhitale, të indeksimit, të integritimit në sisteme TIK dhe realizimin e ndërveprimit. Ky program do të kontribuojë në ofrimin me më efikasitet të shërbimeve elektronike.

Kalimi në qeverisjen dixhitale për shërbimet për qytetarët dhe bizneset nga institucionet e administratës shtetërore do të përfshijë hapat e mëposhtëm, të harmonizuar me nismat e riinxhinierimit të proceseve të shërbimeve, sipas fazave të parashikuara në këtë DPA:

- kalimin e të gjitha shërbimeve *on-line*;

- ndalimin e menjëhershëm të përpunimit manual ose me bazë shkresash të kërkesave për shërbime;

- pranimin e dokumenteve dixhitale ose elektronike duke përfshirë dokumentet mbështetëse si pjesë e kërkesave për shërbime;

- zhvillimin dhe miratimin e zgjidhjeve teknologjike të cilat mbështetin përpunimin e vazhdueshëm (qoftë *on-line* dhe/ose *off-line*) për të zgjidhur çdo problem ndërlidhjeje;

- zbatimin e sigurisë, autentikimit, ruajtjes, disponueshmërisë, mirëmbajtjes së dokumenteve dhe sistemeve dixhitale sipas standardeve të përcaktuara nga AKSHI.

14. OFRIMI I SHËRBIMEVE NË MËNYRË AUTOMATIKE

Miratimi dhe zbatimi i konceptit të ofrimit në mënyrë automatike për shërbimet nga institucionet e administratës shtetërore, për të cilat kejo është e mundur.

Integrimi i plotë i të gjithë procesit të lëvrimin të shërbimeve dhe zotërimi nga administrata shtetërore i një panorame të plotë mbi të dhënat për qytetarin do të bëjë të mundur realizimin e një qasjeje proaktive ndaj kërkesave të qytetarëve për shërbime të caktuara, të cilat do të mund të lëvrohen në mënyrë automatike pa një kërkesë specifike.



“Shërbimi automatik” ka një impakt të rëndësishëm në përmirësimin e përvojës së qytetarit në marrjen e shërbimeve, veçanërisht të shtresave më vulnerabël. Ai do të mbështetet në procese ligjore, teknologjike dhe riinxhinieruese. Në çdo rast, nga zbatimi i kësaj qasjeje në kushtet kur mundësia ekziston, janë të përjashtuara të gjitha ato shërbime për të cilat është i domosdoshëm aplikimi i qytetarit për fillimin e procesit, si në rastin e atyre me karakter sensitiv.

15.ZBATIMI I MIRATIMIT NË HESHTJE PËR SHËRBIME TË PËRZGJEDHURA

Përfshirja e miratimit në heshtje për shërbime të përcaktuara duke rritur llogaridhënien në administratën shtetërore.

Shtirirja e mëtejshme e zbatimit të miratimit në heshtje në shërbimet për qytetarët dhe biznesin nga institucionet e administratës publike do të realizohet për atë kategori shërbimesh për të cilat ajo është e aplikueshme. Në këtë kuadër, do të përfshihet për secilin shërbim përcaktimi i një sistemi gjithëpërfshirës rishikimi, monitorimi dhe vlerësimi, ku rolet dhe përgjegjësitë në shqyrtimin e kërkesave dhe mbikëqyrjen janë të qarta. Ai do të mbështetet nga një platformë TIK që të mundësojë njoftime automatike si gjatë fazave të ndryshme të procesit të shqyrtimit, ashtu si dhe për evidentimin e miratimit në heshtje. Nga pikëpamja e performancës, ky do të konsiderohet një veprim jashtë procedurave standarde dhe do të jetë subjekt i një inspektimi të menjëhershëm. Ai do të përfshihet për shërbimet e përzgjedhura si TKP për punonjësit dhe institucionet përkatëse.

3.3 Planifikimi

Ndërhyrjet e mësipërme kanë shkallë të ndryshme kompleksiteti, gjë e cila ka një impakt të drejtpërdrejtë në kohën e fillimit të tyre, kohëzgjatjen dhe përpjekjet e nevojshme për t'i zbatuar ato. Në tabelën e mëposhtme kategoritë e ndërhyrjeve së bashku me nënkategoritë e evidentuara janë renditur sipas nivelit të kompleksitetit, nga më i ulëti te më i larti, në bazë të katër parametrave në vijim⁷:

- i) Shtirirja që ka të bëjë me madhësinë dhe diapazonin relativ të çdo ndërhyrjeje e që është në përpjesëtim të drejtë me nivelin e kompleksitetit;
- ii) Objekti që ka të bëjë me detyrat dhe veprimtaritë të cilat duhen kryer për zbatimin me sukses të një ndërhyrjeje e që është në përpjesëtim të drejtë me nivelin e kompleksitetit;
- iii) Varësia që ka të bëjë me numrin e faktorëve nga të cilët është e varur një ndërhyrje e që është në përpjesëtim të drejtë me nivelin e kompleksitetit;
- iv) Gatishmëria që ka të bëjë me hapat e hedhur tashmë nga qeveria shqiptare për zbatimin e një ndërhyrjeje e që është në përpjesëtim të zhdrejtë me nivelin e kompleksitetit.

	Ndërhyrja	Parametrat e kompleksitetit				Niveli i kompleksitetit
		Shtirirja	Objekti	Varësia	Gatishmëria	
1	Përgatitja dhe publikimi i kartës së qytetarit	E lartë	I ulët	E ulët	E lartë	I ulët
2	Zbatimi i një mekanizmi të qendëruar për ankesat	E lartë	Mesatar	E ulët	Mesatare	Mesatar
3	Marrja e opinionit të qytetarit për çdo kërkesë për shërbim	E lartë	I ulët	Mesatare	Mesatare	Mesatar
4	Trajnimi dhe shtimi i kapaciteteve	E lartë	Mesatar	E ulët	Mesatare	Mesatar
5 i&ii	Funksionimi i kanaleve të shumëfishta të ofrimit të shërbimit: <i>e-Albania & Celulari</i>	E ulët	Mesatar	E ulët	E lartë	Mesatar
5 iii	Funksionimi i kanaleve të shumëfishta të ofrimit të shërbimit: Qendra e kontaktit për shërbimet	E lartë	Mesatar	Mesatare	E ulët	Mesatar
5 iv	Funksionimi i kanaleve të shumëfishta të ofrimit të shërbimit: <i>Sportelet me një ndalesë</i>	Mesatare	Mesatar	Mesatare	Mesatare	Mesatar
6	Ndarja e funksionit të sportelit (<i>Front Office</i>) nga ajo e zyrës përgjegjëse të shërbimit (<i>Back Office</i>)	E lartë	Mesatar	Mesatare	Mesatare	Mesatar

⁷ Çdo ndërhyrje është vlerësuar në momentin e përgatitjes së kësaj DPA-je sipas nivelit “i ulët”, “mesatar” ose “i lartë” për çdo parametër, duke e krahasuar me të tjerat dhe duke përcaktuar kështu një renditje relative. Niveli i kompleksitetit në total është përllogaritur si një mesatare e nivelit individual të kompleksitetit që lidhet me katër parametrat e identifikuar.



	Ndërhyrja	Parametrat e kompleksitetit				Niveli i kompleksitetit
		Shtirirja	Objekti	Varësia	Gatishmëria	
7 i	Funksionimi i sistemit të menaxhimit të performancës: <i>Sistemi i monitorimit të performancës (SMP)</i>	E ulët	Mesatar	E ulët	E ulët	Mesatar
7 ii	Funksionimi i sistemit të menaxhimit të performancës: <i>Plani i bazuar në rezultate</i>	E lartë	I ulët	E ulët	Mesatare	Mesatar
7 iii	Funksionimi i sistemit të menaxhimit të performancës: <i>Çmimet dhe vlerësimet</i>	E lartë	I ulët	Mesatare	E ulët	Mesatar
8	Zbatimi i parimit FIFO <i>(First in, first out)</i>	E lartë	I ulët	Mesatare	E ulët	Mesatar
9	Dhënia e arsyeve për rastet kur shërbimi nuk lëvrohet	E lartë	Mesatar	E ulët	E ulët	Mesatar
10	Zbatimi i masave disiplinore për vonesat në lëvrimin e shërbimeve	E lartë	I lartë	E lartë	E ulët	I lartë
11	Decentralizimi i kompetencës për ofrimin e shërbimeve	E lartë	I lartë	E lartë	Mesatare	I lartë
12	Garantimi i së drejtës për shërbime	E lartë	I lartë	E ulët	E lartë	Mesatar
13	Kalimi në qeverisjen dixhitale	E lartë	I lartë	E lartë	Mesatare	I lartë
14	Ofrimi i shërbimeve në mënyrë automatike	E lartë	I lartë	E lartë	Mesatare	I lartë
15	Zbatimi i miratimit në heshtje për shërbimet e përzgjedhura	E lartë	I lartë	E lartë	E ulët	I lartë

IV. MBËSHTETJE PËR ZBATIM

4.1 Strukturat drejtuese dhe zbatuese

Angazhimi i qëndrueshëm në nivelin më të lartë dhe nga të gjitha institucionet e administratës shtetërore që japin shërbime për qytetarët dhe bizneset, i shprehur në mirëfunksionimin e strukturës drejtuese dhe zbatuese të reformës për shërbime me në qendër qytetarin, përbën një kusht për të siguruar ruajtjen e vizionit, fokusit dhe vazhdimësisë në të gjithë rrugëtimin e reformës.

Struktura drejtuese e përfshin si nivelin strategjik dhe atë funksional duke harmonizuar në nivelin më të lartë qeveritar vendimmarrjen në bazë të menaxhimit të integruar të planifikimit me miratimin dhe ndjekjen e politikave përkatëse. Kjo e fundit realizohet nga Komiteti i Posaçëm Ndërmnistror, nën drejtimin e Kryeministrit, me pjesëmarrjen e të gjithë ministrave sipas institucioneve të administratës shtetërore në fokus, së bashku me ministrin për çështjet e pushtetit vendor, mbledhja e të cilit organizohet në mënyrë periodike nga ministri përgjegjës i ngarkuar me drejtimin e reformës.

Lidhjen ndërmjet strukturave drejtuese dhe atyre zbatuese e mundësojnë komiteti drejtues me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë institucionalë në zbatimin tërësor të reformës dhe departamenteve kyçe pranë Kryeministrit, si dhe grupi i posaçëm menaxhues i ngritur nga ministri përgjegjës për reformën. Në drejtimin e ministrit, komiteti drejtues realizon vendimmarrjen dhe mbikëqyrjen operacionale, ndërsa grupi i posaçëm siguron planifikimin dhe realizimin e bashkërenduar të veprimtarive për jetësimin e rezultateve. Kapacitetet e duhura menaxhuese pranë ministrit përgjegjës bëjnë të mundur mbështetjen efektive të drejtimit të reformës.

Institucionet e administratës shtetërore me funksione të posaçme në reformën për shërbime me në qendër qytetarin, si ADISA dhe AKSHI, dhe institucionet që kanë përgjegjësinë ligjore për dhënie të shërbimeve publike me natyrë administrative luajnë rolin parësor në zbatimin e politikave të kësaj reforme. Grupet e punës në nivel institucionesh varësie, si dhe ato ministrore përbëjnë mekanizmat për organizimin e brendshëm të punës.

Ndërkohë, grupi i menaxhimit të integruar të politikave (GMIP), i cili drejtohet nga ministri përgjegjës, duke shfrytëzuar në nivel teknik dhe mekanizmin e grupit tematik, shërben për mbështetjen e koordinimit ndër-institucional, niveli më i lartë i të cilit është Komiteti Ndërmnistror.

Në mbështetje të zbatimit dhe suksesit afatgjatë të reformës për shërbime me në qendër qytetarin,



qeveria shqiptare do të adoptojë, në qasjen e grupeve të punës, praktikën e caktimit të kampionit të reformave, i cili do të ketë përgjegjësinë e shkëmbimit të informacionit dhe të koordinimit si brenda institucionit ashtu dhe në nivel ndërinstitucional. Në kuadrin e sistemit të menaxhimit të performancës, do të ketë një vëmendje të posaçme për vlerësimin periodik të kompetencave dhe performancës së kampionëve të reformave, bashkë me një skemë incentivash për mbështetjen e tyre.

4.2 Modelet e financimit

Modelet e financimit të reformës për shërbime me në qendër qytetarin, e cila integron objektivat, masat dhe burimet mbështetëse të detajuara në SNRAP dhe SNSHAD, përfshijnë:

- financimin nga buxheti i shtetit;
- financimin nga partnerët për zhvillim.

Në çdo rast, zgjedhja e modelit më të përshtatshëm ndër modelet e mundshme të financimit do të mbështetet në:

- llojin e nismës dhe rezultateve të parashikuara;
- shpenzime që kryhen vetëm një herë ose janë të përsëritura;
- kërkesa financimi afatgjata ose afatshkurtra;
- kthimin e investimit;
- studimin e fizibilitetit.

4.3 Monitorimi dhe vlerësimi (M&V)

Monitorimi dhe vlerësimi do të luajnë një rol thelbësor për matjen e ndikimit të politikave të reformës për shërbime me në qendër qytetarin, vlerësimin e arritjeve të objektivave dhe identifikimin e drejtimeve kryesore për përmirësim në nivelin e politikave. Si pjesë e M&V do të jenë analizat e rregullta tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore në bazë të një kuadri të rezultateve që do të përfshijë indikatorët përkatës duke iu referuar dhe strategjive të miratuara. Ajo do të ketë parasysh si raportet e ecurisë së zbatimit të ndërhyrjeve të parashikuara, ashtu dhe ato në aspektin e buxhetimit apo rishikimit buxhetor.

Ndërkohë, DPA-ja do të rishikohet e do të rivlerësohet në kuptimin strategjik çdo tre vjet, në bazë të rezultateve të vlerësimit të impaktit, si një instrument i cili do të ndihmojë për të matur nëse janë arritur objektivat e përcaktuar dhe për të orientuar e detajuar punën e mëtejshme. Në këtë kuadër, kontribut të veçantë do të ketë vlerësimi i impaktit social të reformës.

4.4 Komunikimi dhe angazhimi i aktorëve

Strategjia e komunikimit do të mbulojë aspektet e mëposhtme të reformës për shërbime me në qendër qytetarin, si në raport me publikun/përfituesit ashtu dhe punonjësit e administratës shtetërore:

- rritja e ndërgjegjësimit dhe informimit për vizionin, objektivat dhe rezultatet;
- sigurimi i mbështetjes për ndryshim, si për procese të riinxhinieruara, kanale të reja dhe të transformuara të ofrimit të shërbimeve etj.;
- krijimi i besimit të publiku për përdorimin e teknologjisë dhe të shërbimeve elektronike në ndërveprimin me institucionet e administratës shtetërore;
- inkurajimi i kërkesës për përdorimin e shërbimeve të përmirësuara;
- përmirësimi i shkëmbimit të vazhdueshëm të informacionit;
- angazhimi i qytetarëve, si përfituesit kryesorë, në proceset e reformës, si dhe motivimi i punonjësve për të kontribuar në mënyrë efektive dhe në vazhdimësi për arritjen e objektivave.

Qeveria shqiptare do të vazhdojë të zbatojë një platformë angazhimi të gjerë të përfituesve, duke pasur në vëmendje pjesëmarrjen nga grupet në nevojë dhe ato vulnerabël, për të marrë opinione dhe sugjerime si në nivel politikash, ashtu dhe prioritizimin apo vlerësimin e ndërhyrjeve. Përveç konsultimeve apo kanaleve tradicionale, ky angazhim do të mundësohet dhe përmes shfrytëzimit të zgjidhjeve TIK.



VENDIM

Nr. 385, datë 25.5.2016

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE TEK AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA) TË MJEDISEVE TË PRONËS “NDËRTESE - TRUALL”, ME NR. PASURIE 3/703, LAGJJA NR. 1, KRUIË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 818, DATË 6.12.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve tek Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), të mjediseve të katit të parë dhe të një sipërfaqeje prej 30 (tridhjetë) m² e katit të dytë të ndërtesës, me numër pasurie 3/703, zona kadastrale 8621, lagja nr. 1, Krujë, me sipërfaqe totale 330.2 (treqind e tridhjetë pikë dy) m², për t’ua përdorur si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë administrative të ADISA-s sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Prona me numër rendor 30, me emërtimin “Ndërtesë”, lagja nr. 1, Krujë, hiqet nga lista e inventarit që i bashkëlidhet vendimit nr. 818, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave.

3. Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe kryeregjistruesi Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE (Per inventarizimin e pronave te veçanta)										
Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)			Identifikoi: Matilda Qesja Përgjegjëse e Sektorit Juridik, Drejtoria e Shërbimeve Mbeshtetëse dhe Godinave, Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)							
Fusha e përdorimit të Pronës: Administrate			Supervizori: Blierta Xhako Kordinatorator, Departamenti i Inovacionit dhe Mireqeverisjes, Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike							
Aprovoi: Saemira Pina (Sjipali) Drejtor i Kabinetit, Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike										
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones.	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti perdores Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8621	3/703	Ndertese	Lagja nr. 1, Kruje	330.2 m ²	330.2 m ²	administrate	Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)	Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)	Kati i pare i nderteses



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

5-Jan				30m ²	30m ²	administrative	Qendra e Ofitimit te Shërbimeve Publike te Integruara (AOISA)		Kati i dyte i ndërtuar
							Qendra e Ofitimit te Shërbimeve Publike te Integruara (AOISA)	Qendra e Ofitimit te Shërbimeve Publike te Integruara (AOISA)	

VENDIM

Nr. 386, datë 25.5.2016

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA E
MADHE E TIRANËS (KOMUNA E
PARISIT – RRUGA E KAVAJËS),
SHTESA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë.22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e madhe e Tiranës (Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës), shtesa”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë,

sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “objekt”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 48 352 015 (dyzet e tetë milionë e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëmbëdhjetë) lekësh, nga të cilat:

- “truall”, me sipërfaqe 949 m², me vlerë 17 071 298 (shtatëmbëdhjetë milionë e shtatëdhjetë e një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë;

- “objekte”, me vlerë 31 280 717 (tridhjetë e një milionë e dyqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimi për pasuritë “truall” dhe “objekte”, prej 48 352 015 (dyzet e tetë milionë e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëmbëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësimi”, planifikuar për Autoritetin Rrugor-Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar ZVRPP”, “Vërtetim hipotekor”, “Certifikatë pronësie”, të likuidohen,



për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 e 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, dhe, me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
 REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI “UNAZA E MADHE E TIRANËS”
 (SEGMENTI KOMUNA E PARISIT - RRUGA E KAVAJËS) (SHITESAT)

Nr. rendor	PRONARI			Z. Kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqja e objekteve (banesë) m ²	Çmimi mesatar (l/m ²)	Vlera sipas çmimit mesatar (lekë)	Vlera sipas preventivit	VLERA TOTALE (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Bajram	Zyber	Osmani	8260	1/82/ND	135	69,285	9,353,475		9,353,475.0	Certifikatë pronësie
2	Frederik	Ligor	Todhri	8260	1/64/ND	50	69,285	3,464,250		3,464,250.0	Konfirmuar ZVRPP
3	Astrit		Lipo	8240	1//39	75	69,285	5,196,375		5,196,375.0	Certifikatë pronësie
4	Bashkepronaret Kocollari			8260	1/66+1-2	7.5	69,285	519,638		519,637.5	Certifikatë pronësie
5	Gurazie Xhevit	Elmaz Alush	Preci Preci	8240	3/673	29.5	69,285	2,043,908		2,043,907.5	Certifikatë pronësie
6	Aurela Mariglen Suada Suzana	Trendafil Trendafil Trendafil Ali	Bregasi Bregasi Karaibrahimi Bregasi	8260	1/279-ND	78	69,285	5,404,230		5,404,230.0	Certifikatë pronësie
7	Dulejman		Karaj	8240	2/155				587,462	587,462	Leje ndërtimi (karburant, shpronësim pjesërisht)
8	Fiqiri Petrit	Jakup Jakup	Doka Doka	8260	1/383-ND	68	69,285	4,711,380		4,711,380	Dokument pronësie (proces konfirmimi)
	Shuma							30,693,255	587,462.0	31,280,717.0	



LISTA E PRONAREVE, PASURITË E TË CILËVE SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I “UNAZA E MADHE E TIRANËS”
(SEGMENTI KOMUNA E PARISIT - RRUGA E KAVAJËS) (SHITESAT TOKAT)

Nr. rendor	PRONARI			Z. Kadastrale	Nr. pasurie	VLERA E SHPRONËSIMIT			Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	ATËSIA	MBIEMRI			Sip. (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)		
1	Njazi Bejaz Shaho			8260	2/433	400	10182	4072800	4072800	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Fatime Zeqo Ymeri	Fatmir Faslli Ymeri	Sejrije Hysen Ymeri	8260	1/54+1-3	30	10182	305460	305460	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Bardhyl Islam Spaho			8260	2/437	63.8	10182	649612	649611.6	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Ymer Sula			3292	291/252/1	118	10182	1201476	1201476	Proces regjistrimi
5	Hasan Zeqiri			3292	291/255/1	270	10182	2749140	2749140	Proces regjistrimi
6	Skender Zeqiri			3292	291/253/2	144	10182	1466208	1466208	Proces regjistrimi
7	Sefer Dule Aga			3292	291/171/1	136	10182	1384752	1384752	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	Haxhi Ibrahim Dushku			3292	291/251/1	300	10182	3054600	3054600	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Tefik Gjata			3292	291/177	106.5	10182	1084383	1084383	Proces regjistrimi
10	Anastas Coli	Jemin	Coli	8240	3/234	31	10182	315642	315642	Proces konfirmimi
	SHUMA					1599.3		16284073	16284073	

LISTA E PRONAREVE, PASURITË E TË CILËVE SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I “UNAZA E MADHE E TIRANËS”
(SEGMENTI KOMUNA E PARISIT - RRUGA E KAVAJËS) (SHITESAT OBJEKTET)

Nr. rendor	PRONARI			Z. Kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqja e objekteve (banese) m ²	Çmimi mesatar(l/m ²)	Vlera sipas çmimit mesatar (lekë)	Sipërfaqja e objekteve (podrum lokal) m ²	Vlera sipas koston së ndërtimit (lekë)	VLERE TOTALE (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri									
1	Fatime Fatmir Sejrije	Zeqo Faslli Hysen	Ymeri Ymeri Ymeri	8260	1/54+1-3	30	69,285	2,078,550			2,078,550	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Bashkim	Shaziman	Agolli	8260	1/54+1-7	20	69,285	1,385,700			1,385,700	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Njazi		Shaho	8260	2/266-ND	86	69,285	5,958,510			5,958,510	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Bardhyl		Spaho	8260	2/437	42.5	69,285	2,944,613			2,944,613	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Fadil	Nebi	Mejdani	8240	3/280-ND	130	69,285	9,007,050			9,007,050	Certifikatë pronësie (pritet konfirmim nga ZVRPP-ja)
6	Nebi		Mejdani	8240	3/265-ND	134	69,285	9,284,190			9,284,190	Certifikatë pronësie (pritet konfirmim nga ZVRPP-ja)



7	Shkelqim Rabian	Bekdash Adem	Barzezi Barzezi	8240	3/378-ND	155.6	69,285	10,780,746	115.2	8,245,961	19,026,707	Certifikatë pronësie (pritet konfirmim nga ZVRPP-ja)
8	Anisa Florjana	Servet Servet	Tenaj Zeqiri	8260	2/189-ND	50.9	69,285	3,526,607			3,526,607	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Ionja sh.p.k			8240	3/238-ND	135.4	69,285	9,381,189			9,381,189	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	Petrit	Hyqmet	Mejdani	8240	3/381-ND	192	69,285	13,302,720			13,302,720	Certifikatë pronësie
11	Tefik		Gjata	3292	291/177	68	69,285	4,711,380			4,711,380	Proces regjistrimi
12	Hasan		Zeqiri	3292	291/255/1	32	69,285	2,217,120			2,217,120	Proces regjistrimi
13	Skender		Zeqiri	3292	291/253/2	74	69,285	5,127,090			5,127,090	Proces regjistrimi
14	Ymer		Sula	3292	291/252/1	96	69,285	6,651,360			6,651,360	Proces regjistrimi
15	Haxhi	Ibrahim	Dushku	3292	291/251/1	70	69,285	4,849,950			4,849,950	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
16	Ramazan Kumrije		Tufa Tufa	8260	1/282-ND	88.8	69,285	6,152,508			6,152,508	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
17	Besim	Beqir	Kaperi	3292	291/250	2	69,285	138,570			138,570	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
18	Ramazan Donika		Serjani Shemshiri	8260	1/157-ND	61	69,285	4,226,385			4,226,385	Certifikatë pronësie
19	Vitmon		Dhoraj	3292	291/175	50	69,285	3,464,250			3,464,250	Certifikatë pronësie
	SHUMA					1518,2		101.724.237	115,2	8.245.961	109.970.198	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTERIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
 AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

(SEGMENTI KOMUNA E PARISIT - RRUGA E KAVAJËS)
 (SHITESAT TOKAT)

Nr. rendor	PRONARI			Z. Kadastrale	Nr. pasurie	VLERA E SHPRONËSIMIT			Vlera totale (lekë)	Shënime
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI			Sip. (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)		
1	Bashkëpronarët Preci			8240	3/673	136	20.916	2.844.576	2,844,576	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Bashkëpronarët Caushllari			8240	3/672	143	20.916	2.990.988	2,990,988	Proces konfirmimi
3	Fredi	Yzeir	Çami	8260	1/54+1-4	20	30.783	615.660	615,660	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Qemal		Çoku	3292	291/179	21	3.413	71.673	71,673	Barrë hipotekore
5	Qemal	Avdi	Mersini	3292	112/33	43	3.413	146.759	146,759	Kufizim nga ZVRPP-ja
6	Qemal	Avdi	Mersini	3292	112/35	126	3.413	430.038	430,038	Kufizim nga ZVRPP-ja
7	Shqiponja	Belul	Peza	8240	3/699	308	20.916	6.442.128	6,442,128	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	Bashkëpronarët Koçollari			8260	1/66+1-2	16	30.783	492.528	492,528	Proces konfirmimi
9	Elmaz	Vesel	Miska	3292	291/191/1	42	3.413	143.346	143,346	Proces konfirmimi
10	Virgjinush	Hasan	Nezo	8260	1/355	94	30.783	2.893.602	2,893,602	Proces konfirmimi
	SHUMA					949			17,071,298	

**VENDIM**

Nr. 387, datë 25.5.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “PËRMIRËSIMI I SHITRESAVE RRUGORE FUSHË-KRUJË - THUMANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Përmirësimi i shitresave rrugore Fushë-Krujë - Thumanë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “arë”, “truall” dhe “objekt”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 16 686 204 (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e katër) lekësh, nga të cilat:

- tokë “arë” dhe “truall”, me sipërfaqe 12 648 m², me vlerë 5 409 102 (pesë milionë e katërqind e nëntë mijë e njëqind e dy) lekë;

- “objekt”, me sipërfaqe 116 m², me vlerë 11 277 102 (njëmbëdhjetë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e dy) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë “arë”, “truall” dhe “objekt”, prej 16 686 204 (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e katër) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri

“Shpronësimet”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar ZVRPP”, “Vërtetim hipotekor”, “Certifikatë pronësie”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 e 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'i vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E SHPRONËSIMIT “PËRMIRËSIMI I SHITRESAVE RRUGORE FUSHË-KRUJË-THUMANË”

Nr.	Pronari			Bashkia ose fshati	Z.K	Nr. pas.	Sip. totale	Sip. e shpronësimit arë	Sip. e shpronësimit ndërtesë	Sip e shpronësimit simit Truall	ÇMIMI ARË	Çmimi Truall	Çmimi ndërtesë	Vlera totale	Konfirmimet	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri													
1	ISMET	RIZA	AHMETI	HASAN	1934	26/13	22613	878			296			259888	KONF. ZVRPP	
2	SELAM	IBRAHIM	SHALA	HASAN	1934	21/47	2000			29		312		9048	KONF. ZVRPP	
3	XHEMAL	MUAHARREM	GASHI	HASAN	1934	8/13/1	1577	13			296			3848	KONF. ZVRPP	
4	FATMIR	MUAHARREM	GASHI	HASAN	1934	8/31	5332	72			296			21312	KONF. ZVRPP	
5	ELIDA	NUE	SHKRETA	LUZ	2537	68/44	2489	32			253			8096	KONF. ZVRPP	
6	GLADIOLA	NUE	MUSTEQJA	LUZ	2537	68/42	2439	351			253			88803	KONF. ZVRPP	
7	LEONORA	NUE	LLESHI	LUZ	2537	68/40	2399	716			253			181148	KONF. ZVRPP	
8	LEONORA	NUE	LLESHI	LUZ	2537	68/38	2279	1618			253			409354	KONF. ZVRPP	
9	MARIE	ZEF	MUSTEQJA	LUZ	2537	68/36	2212	540			253			136620	KONF. ZVRPP	
10	KASTRIOT	ZEF	MUSTEQJA	LUZ	2537	68/35	1305	330			253			83490	KONF. ZVRPP	
11	VALENTIN	SHEFQET	SYMKALOVA	LUZ	2537	4/19	4990	315			253			79695	KONF. ZVRPP	
12	VALENTIN	SHEFQET	SYMKALOVA	LUZ	2537	4/20	3974	14			253			3542	KONF. ZVRPP	
13	NIKOLL	NDRE	BARDHOKU	DERVEN	1475	54/1	6000	95			391			37145	KONF. ZVRPP	
14	TEREZE	TOM	SIMONI	DERVEN	1475	54/2	1100	89			391			34799	KONF. ZVRPP	
15	TEREZE	TOM	SIMONI	DERVEN	1475	54/12	4720	58			391			22678	KONF. ZVRPP	
16	EDMOND	GJIN	LULI	DERVEN	1475	51/13	1655			4		387		1548	KONF. ZVRPP	
17	PJETER	PASHK	BARDHOKU	DERVEN	1475	51/8	1180	281			391			109871	KONF. ZVRPP	
18	AGIM	BAJRAM	KURTI	DERVEN	1475	49/24	4236			166		387		64242	KONF. ZVRPP	
19	GEG	ZEF	GJOKEJA	DERVEN	1475	43/24	3696	137			391			53567	KONF. ZVRPP	
20	MHILL	ZEF	GJOKEJA	DERVEN	1475	43/23	1550	67			391			26197	KONF. ZVRPP	
21	FRROK	ZEF	GJOKEJA	DERVEN	1475	43/22	1502	104			391			40664	KONF. ZVRPP	
22	GJON	NDRE	LULI	BORIZANE	1247	350/3	5480	836			343			286748	KONF. ZVRPP	
23	MEHDI	BAJRAM	KURTI	BORIZANE	1247	347/20	9050	55			343			18865	KONF. ZVRPP	
24	DEMIR	BERAM	KURTI	BORIZANE	1247	347/4	6700	11			343			3773	KONF. ZVRPP	
25	ZENEL	TAHIR	VOGLI	BORIZANE	1247	346/14	3250	64			343			21952	KONF. ZVRPP	
26	ISMAIL	BESIM	VOGLI	BORIZANE	1247	343/3	7650	651			343			223293	KONF. ZVRPP	
27	SKENDER	SELMAN	VOGLI	BORIZANE	1247	343/4	8480	845			343			289835	KONF. ZVRPP	SEKUESTRO
28	ALBERT	MYFTAR	VOGLI	BORIZANE	1247	343/7	6280	275			343			94325	KONF. ZVRPP	
29	SHOQERIA PRIVATE DOKU-P SH.P.K			BORIZANE	1247	343/15	1600	16			343			5488	KONF. ZVRPP	SEKUESTRO
30	ISA	MUAHARREM	BALLA	BORIZANE	1247	346/13	6700	79			343			27097	KONF. ZVRPP	
31	AGIM	AVDI	RRYTA	K-THUMANE	2182	230/1	4335	57			362			20634	KONF. ZVRPP	KREDI
32	ALI	MUSTAFA	FARRUKU	THUMANE	3599	214/10	5500	1267			442			560014	KONF. ZVRPP	
33	HAJRIE	AHMET	ZENELI	THUMANE	3599	86/53	6100	2238			442			989196	KONF. ZVRPP	
34	ARTUR	BESIM	LAMA	THUMANE	3599	87/27	3000	301			442			133042	KONF. ZVRPP	
35	ARTUR	XHEMALI	JANGOZI	THUMANE	3599	87/28	2063	9			442			3978	KONF. ZVRPP	
36	SEJFULLA	AHMET	FRESKU	THUMANE	3599	87/25	6400	390			442			172380	KONF. ZVRPP	SEKUESTRO
37	PERPARIM	XHEKE	BUSHI	THUMANE	3599	87/21	1860			1207		442		533494	KONF. ZVRPP	
38	PERPARIM	XHEKE	BUSHI	THUMANE	3599	87/21	116		116					11.277.102	KONF. ZVRPP	KARBURANT
39	GJIN	GJOK	MENGA	LUZ	2537	4/24	4957	125			253			31625	KONF. ZVRPP	
40	ISMAIL	SUL	QIRA	BORIZANE	1247	343/12	7000	366			343			125538	KONF. ZVRPP	
41	LUAN	HASAN	KEQI	THUMANE	3599	86/41	1244	435			442			192270	KONF. ZVRPP	NE PROCES SAKTESIMI
									11,242		116	1406		16686204		

**VENDIM**

Nr. 388, datë 25.5.2016

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR “LIBRAZHD –
Qafa e Studnës (SHTESA)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë.22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Librazhd – Qafa e Studnës (shtesa)”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “arë”, “kultura bujqësore dhe drurë frutorë”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 2 651 168 (dy milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë, nga të cilat:

- arë, me sipërfaqe 3 007 m², me vlerë 523 218 (pesëqind e njëzet e tre mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë) lekë;

- kultura bujqësore dhe drurë frutorë, me vlerë 2 127 950 (dy milionë e njëqind e njëzet e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë “arë”, dhe “kultura bujqësore dhe drurë frutorë”, prej 2 651 168 (dy milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësime”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar ZVRPP”, “Vërtetim hipotekor”, “Certifikatë pronësie”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 e 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Librazhd, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Librazhd të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Librazhd për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi



MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
 REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
 SEKTORI SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "LIBRAZH-D. Q. STUDNËS (shtesa)
 (TOKË ARË, KULTURAT BUJQËSORE DHE DRUFRUTORE) Shtesat

Nr.	PRONARI		Z.K.	NR. PAS	Lloji i pasurisë	Sip. e shpronës. me VKM nr. 715 dt.29.10.2014	Sip. e shpronës.	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Kultura bujqësore. drufr. Vlera (lekë)	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri, atësia, mbiemri											
1	Shefki Dosku		1517	678	Arë	390				86000	86000	Konfirmim ZVRPP
2	Xhemal Dosku		1517	675	Arë	145				130000	130000	Konfirmim ZVRPP
3	Shaban Dosku		1517	666/12	Arë	93				7400	7400	Konfirmim ZVRPP
4	Sami Dosku		1517	666/11	Arë	68				12500	12500	Konfirmim ZVRPP
5	Drini Abaz Dosku		1517	666/10	Arë	47				10000	10000	Konfirmim ZVRPP
6	Gafur Dosku		1517	666/9	Arë	92				2400	2400	Konfirmim ZVRPP
7	Riza Dosku		1517	663/9	Arë	53				11500	11500	Konfirmim ZVRPP
8	Riza Dosku		1517	663/11	Arë	41				14000	14000	Konfirmim ZVRPP
9	Idajet Bëçaku		1517	663/8	Arë	31				7500	7500	Konfirmim ZVRPP
10	Bujar Muça		1517	650/4	Arë	338				32400	32400	Konfirmim ZVRPP
11	Naze Muça		1517	650/3	Arë	211				15900	15900	Konfirmim ZVRPP
12	Petrit Allushi		1517	1/2	Arë	526				330000	330000	Konfirmim ZVRPP
13	Petrit Allushi		1517	1/3	Arë	76				36000	36000	Konfirmim ZVRPP
14	Halil Brahja		1517	20/1	Arë	2600	728	174	126672	54150	180822	Certifikatë pronësie
15	Naze Musa Muça		1517	654/1	Arë		261	174	45414		45414	Konfirmim ZVRPP
16	Ismail Qoshi		3913	540	Arë	218				54250	54250	Konfirmim ZVRPP
17	Nazmi Qoshi		3913	538	Arë	230				20600	20600	Konfirmim ZVRPP
18	Dhimiter (Bashkim) Qoshi		3913	536	Arë	184				35500	35500	Konfirmim ZVRPP
19	Nazmi Qoshi		3913	535/1	Arë	483				40700	40700	Konfirmim ZVRPP
20	Hamit Shuli		3913	520/2	Arë	193				19500	19500	Konfirmim ZVRPP
21	Petrit Alla		3913	543	Arë	181				87000	87000	Konfirmim ZVRPP
22	Xhezar Alla		3913	56	Arë	454				25650	25650	Konfirmim ZVRPP
23	Uran Alla		3913	57	Arë	448				21300	21300	Konfirmim ZVRPP
24	Arben Alla		3913	71	Arë	520				19500	19500	Konfirmim ZVRPP
25	Hamide Alla		3913	72	Arë	132				44200	44200	Konfirmim ZVRPP
26	Hamide Alla		3913	1233	Arë	156				39000	39000	Konfirmim ZVRPP
27	Haki Alla		3913	81	Arë	327				41200	41200	Konfirmim ZVRPP
28	Beqir Dilaver Shpata		3913	558	Arë		316	174	54984	132600	187584	Konfirmim ZVRPP
29	Shefki Hasan Qoli		3913	576/1	Arë		346	174	60204	124800	185004	Konfirmim ZVRPP
30	Hazbi Dilaver Boci		3913	560/1	Arë		296	174	51504	179000	230504	Konfirmim ZVRPP
31	Qamil Izet Boci		3913	295/3	Arë		80	174	13920	79500	93420	Konfirmim ZVRPP
32	Qamil Izet Boci		3913	499	Arë		250	174	43500	132000	175500	Konfirmim ZVRPP
33	Gjelberim Xhaferr Alla		3913	559/1	Arë		155	174	26970	80700	107670	Konfirmim ZVRPP
34	Izmir Xhaferr Alla		3913	559/2	Arë		140	174	24360	63000	87360	Konfirmim ZVRPP
35	Andon Xhaferr Alla		3913	559/3	Arë		140	174	24360	85200	109560	Konfirmim ZVRPP
36	Jani Beqir Qoshi		3913	753	Arë		295	174	51330	53000	104330	Konfirmim ZVRPP
							3007		523218	2127950	2651168	

**VENDIM****Nr. 389, datë 25.5.2016****PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR. 301, DATË 8.4.2015, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS
400 KV VAU I DEJËS-MORINË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 301, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3, sipërfaqja “4 147.8 (katër mijë e njëqind e dyzet e shtatë pikë tetë) m²”, ndryshohet dhe zëvendësohet me “4 281.8 (katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e një pikë tetë) m²”.

2. Në pikat 3 dhe 4, vlera “14 037 979 (katërmëdhjetë milionë e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë” ndryshohet dhe zëvendësohet me “15 042 979 (pesëmbëdhjetë milionë e dyzet e dy mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë”.

3. Tabela e miratuar, që i bashkëlidh vendimit në fuqi, zëvendësohet me tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS 400 kV VAU I DEJËS - MORINË

Qarku: Shkodër, Kukës

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: ndërtim, tokë arë, truall, kullotë

Nr.	Numri i shtyllës	Te dhëna për pronësinë							Sip. shpronësim për banesë m ²	Sip. shpronësim për shtyllë m ²	Vlera e shpronësimit në lekë/m ²	Vlera e shpronësimit në lekë për banesë	Vlera e shpronësimit në lekë për shtyllë	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. Kadastral	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sasia sip. pronës m ²						
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
Komuna Vau Dejës														
Karme														
1	26	Pretendues			2097	112	Arë	10190		140	225		31500	
2	27	Pretendues			2097	154	Arë	133700		105	225		23625	
Ndërmjet 26-27		Pretendues			2097	130	Shtëpi Banimi		85		28175	2394875		Pa certifikatë pronësie
					Sipërfaqja totale shpronësimi m ²				245					
					Vlera totale në lekë						2394875	55125		
Fshati Karme														
3	34	Pretendues			2098	3	Arë	7017		97	225		21825	
					Truall			200						
4	35	Mark	Marash	Zefi	2098	289	Arë	1700		140	225		31500	
5	36	Gjon	Marash	Zefi	2098	289	Arë			208	225		46800	
					Sipërfaqja totale shpronësimi m ²				445					
					Vlera totale në lekë							100125		
Komuna Koman														
Koman														
Ndërmjet 50-51		Pretendues			2209		Shtëpi Banimi		165		28175	4648875		Nuk ka informacion
Ndërmjet 50-51		Pretendues			2209		Shtëpi Banimi		93		28175	2620275		Nuk ka informacion
					Sipërfaqja totale ndërtimi për shpronësimin m ²				258					
					Vlera totale në lekë						7269150			
Bashkia Pukë														
Buzhale														
	61	Arben	Gjergj	Preka	1340	112	Arë	5150		104.4	100		10440	Me certifikatë
					Sip. Totale				104.4					
					Vlera Totale në lekë							10440		
Komuna Qelez														
Fshat Bushat														
6	72	Prendush	Pal	Vata	1330	223	Arë	1500		108	100		10800	
7	73	Pjeter	Mark	Kola	1330	175	Arë	1300		133	100		13300	
8	74	Ndue	Pal	Vata	1330	127	Arë	11250		133	100		13300	
9	75	Pretendues			1330	336	Arë	3125		87	100		8700	
					Sipërfaqja totale shpronësimi m ²				461					
					Vlera totale në lekë							46100		
Komuna Iballë														
Fshati Berishë Vendi														
10	86	Pretendues			1163	322	Arë	796		105	100		10500	
					Sipërfaqja totale shpronësimi m ²				105					
					Vlera totale në lekë							10500		
Fshati Berishë e Vogël														



11	89	Pretendues			1162	493	Arë	4236		140	100		14000
12	90	Pretendues			1162	355	Arë	120		97	100		9700
13	91	Pretendues			1162	244	Arë	832		133	100		13300
14	92	Pretendues			1162	244	Arë	832		118	100		11800
					Sipërfaqja totale shpronësimi m ²								488
					Vlera totale në lekë								48800
Fshat Shopel													
Ndërmjet 95-96		Zef	Boç	Prendi	3402	176	Shtëpi Banimi		134		7500	1005000	Me certifikatë
15	96	Prendush	Frok	Kola	3402	146	Arë	2503		133	100		13300
					Sipërfaqja totale shpronësimi m ²								134
					Vlera totale në lekë								133
Fshati Berishë e Sipërme													
16	106	Pretendues			1160	861	Arë	7768		117	100		11700
17	107	Pretendues			1160	861	Arë	7768		133	100		13300
18	111	Pretendues			1160	199	Arë	289		150	100		15000
19	112	Pretendues			1160	19	Arë	1556		165	100		16500
					Sipërfaqja totale shpronësimi m ²								565
					Vlera totale në lekë								56500
Komuna Bugjon													
Fshat Bugjon													
20	117	Pretendues			1300	917	Arë	12331		140	100		14000
21	118	Pretendues			1300	827	Arë	5499		117	100		11700
22	119	Gjelosh	Stak	Sheqeri	1300	703	Arë	2503		117	100		11700
23	120	Mark	Mic	Sokoli	1300	612	Arë	1613		149	100		14900
24	121	Gjin	Lek	Pjetri	1300	349	Arë	707		149	100		14900
					Sipërfaqja totale shpronësimi m ²								672
					Vlera totale në lekë								67200
Komuna Fierzë													
25	128	Pretendues			1619	526	Arë	972		118	100		11800
26	129	Pretendues			1619	372	Arë	1446		87	100		8700
27	130	Mhill	Nik	Bala	1619	131	Arë	3931		133	100		13300
					Sipërfaqja totale shpronësimi m ²								338
					Vlera totale në lekë								33800
Bashkia B. Curri													
Bujan													
	148	Bashkëpronar Kurti dhe Margjeka			1301	588/2	Arë	4404.6		104.4	160		16704
Ndërmjet 147 -148		Bashkëpronar Kurti dhe Margjeka			1301	592/1	Shtëpi Banimi		144		27190	3915360	Me certifikatë
					Sipërfaqja totale shpronësimi m ²								144
					Vlera totale në lekë								104.4
											13579385	1463594	
Sipërfaqja totale shpronësimi për shtylla 3660.8 m ² me vlerë totale në lekë 458594											Shuma Totale		15042979
Sipërfaqja totale shpronësimi për ndërtim 621 m ² me vlerë totale në lekë 14584385													

**URDHËR****Nr. 4129, datë 2.6.2016****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, nenit 7, pikës 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 28, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë në datën 3.6.2016, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Arben Isaraj.

2. Ngarkohet zëvendësministri, z. Arben Isaraj, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 252 lekë